



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr No.Br.

21/08/2024

02/360



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 25.06.2024 dhe filloi në ora: 14:15.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Veton Zogaj, Hamit Lima, Sadik Vrenezi, Gentianë Hoti, Rukije Bytyqi, përfaqësuesi nga OSBE Auron Gashi dhe zyra për informim.

Mungon: Arlindë Rudi (PDK) me arsye.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!
Hapi mbledhjen e -I- (parë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa..
Kush është për këtë rend të ditës?
Me vota unanime, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë nr.04/571 datë:24.06.2024, për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake për vitin 2024.
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Drejtorja për Ekonomi dhe Financa e ka përgadit Kornizën afatmesme buxhetore. Drejtori është prezent dhe na informon më hollsisht.

Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi: Është obligim Ligjor që para jush të prezantohet dhe të aprovohet deri me 30 qeshor. Totali i Kornizës afatmesme buxhetore është 22,116,019.00E, mirëpo duke qenë mbështetur dhe në kërkesën nëse na aprovonë rritjen e limitit të hyrave vetanake. Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2025 përmban këta kufijë buxhetorë:

paga dhe medetje:11,265,065.00E ,mallra dhe shërbime:2,600,200.00E, komunale:655,000.00E, subvencione dhe transfere:700,000.00E, investime kapitale:6,895,754.00E. 600.000.00E është më lartë se sa kufijtë që na kanë dhënë ministria. Kërkoj nga ju që të miratohet.

Veton Zogaj: Ne si asamble e kemi si obligim ligjor me miratu deri me 30 qeshor. Profia tha 600.000,00E është më lartë se sa kufijtë që ju kanë dhënë, është më mirë me u konsultu dhe me nivelin qendror nëse na lejohet, mos të bëhet shkelje ligjore nëse e votojm në asamble.

Drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa: Pa 600,000.00E që i kemi shtu na, buxheti do ishte 21 e gjysmë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?

Për: 6

Kundër:0

abstenim:1

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë nr.04/571 datë:24.06.2024, për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake për vitin 2024.

Drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa: Rritja e kufirit të të hyrave vetanake është në shumë prej 2,200,000.00€

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për miratimin i kërkesë nr.04/571 datë:24.06.2024, për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake për vitin 2024?

Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesa e parashtruar nga Liman Toplana, i cili është me sëmundjen e kancerit.

Kërkesa e parashtruar nga Durim Zulfaj i cili këkon ndihmë financiare pasi fëmija është djegur dhe ka shpenzime të mëdha për ta trajtuar.

Kërkesa e parashtruar nga Shpejtim Paqarizi, i cili këkon ndihmë për vajzën e cila vuan nga paraliza cerebrale, ngecje në zhvillimin psikomotorik. Kush është për që kërkesat e parashtruara nga Liman Toplana, Durim Zulfaj dhe Shpejtim Paqarizi të ju ndahen nga 500E për secilën? Me vota unanime këtyre kërkesave u ndahen nga 500E për secilën.

Kërkesa e parashtruar nga Adhuresa Bytyqi, e cila përdor aparatit e dëgjimit qe tetë vite dhe për shkak të vjetërsisë ky aparat duhet ndërruar, i cili kushton 24,500.00E dhe duhet siguruar jashtë shtetit.

Kërkesa nga Selajdin Sopaj kërkon ndihmë financiare pasi vuan nga kanceri.

Kush është që këtyre dy kërkesave të ju ndahen nga 500E?

Me vota unanime këtyre dy kërkesave u ndahen nga 500E.

Kërkesa e parashtruar nga Sylejman Hoti, i cili vuan nga kanceri. Kush është që Sylejman Hoti ti

ndahen 500E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E

Kërkesa nga Sanije Krasniqi e diagnostifikuar me sëmundje kronike, e operuar nga zemra.

Kërkesa e parashtruar nga Habibe Karaxha ka hipertension arterial, anemi sekondare, plogështi.

Kush është për që këtyre dy kërkesave të ju ndajm nga 400E?

Me vota unanime këtyre dy kërkesave u ndahen për secilën nga 400E.

Kërkesa e parashtruar nga Naim Robaj, i cili vuan nga hyperplasio prostatae, syndrome lumbalis lat sin. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 400E.?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 400E

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:14:40.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Agjend Thaçi

